



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 18708 Prot.

Shkodër, me 17.7.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Ju dërgojmë për shqyrtim dokumentacionin e projekt-vendimit “Për Miratim e Gjerësisë së Zonave të Rezervuara për Varrezat”

Bashkëlidhur po ju dërgojmë:

- Relacionin Shpjegues
- Mendimin pozitiv të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, me Nr.532/1 Prot., datë 01.07.2026
- Projekt vendim “Për Miratim e Gjerësisë së Zonave të Rezervuara për Varrezat”

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR
BENET BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z / KRYETAR

ALBAN PREKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. ____ Prot.

Shkodër, me _____.2026

PROJEKT-VENDIMI

Nr. _____, datë _____.2026

**“PËR MIRATIM E GJERËSISË SË ZONAVE TË REZERVUARA
PËR VARREZAT”**

Këshilli i Bashkisë Shkodër, sot me datë ____/____/2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; nenin 4 të Ligjit Nr.9220, datë 15.4.2004 “Për Administrimin e Shërbimit të Varrimit”, i ndryshuar, VKM Nr. 712, datë 29.10.2014 “Për Miratimin e Rregullores Teknike Për Projektimin dhe Ndërtimin e Varrezave në Territorin e Republikës së Shqipërisë”, Kreun VII të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.5, datë 16.10.2017, rishikuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.9, datë 28.12.2020, si dhe në mendimin pozitiv të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, me Nr.532/1 Prot., datë 01.07.2026,

V E N D O S I:

1. Miratimin e gjerësisë së zonës së rezervuar (brezit sanitar) për varrezat në territorin e Bashkisë Shkodër, në 101 (njëqind e një) metra, e matur nga kufiri i varrezës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë dhe drejtoritë përkatëse të bashkisë Shkodër, sipas strukturës organizative dhe përgjegjësisë së tyre.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas shpalljes.

K R Y E T A R

BENET BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z. KRYETAR

ALBAN KURDI



*Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe
Kontrollit të Territorit*

Mikel KAPSAJ



*Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të
Territorit*

Dorina ISUFI



Drejtoria e Juridike

Brikena MJEDA



*Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të
Territorit*

Dionis DRAGANI



*Drejtoria e Përgjithshme Juridike,
Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
Mbështetëse*

Griselda DAMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot.

Shkodër, me _____._____.2026

RELACION

**“PËR MIRATIM E GJERËSISË SË ZONAVE TË REZERVUARA
PËR VARREZAT”**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër.

Të nderuar këshilltarë,

Në kuadër të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të Bashkisë Shkodër, janë evidentuar vështirësi në implementimin e parashikimeve që lidhen me gjerësinë e zonave të rezervuara (brezave sanitarë) për varrezat, të cilat në disa raste krijojnë kufizime të konsiderueshme për zhvillimin dhe administrimin e territorit.

Ligji nr. 9220, datë 15.04.2004, "Për administrimin e shërbimit të varrimit", i ndryshuar, në nenin 4 "Zona e rezervuar", përcakton se për qendrat e banuara me popullsi mbi 10.000 banorë, gjerësia e zonës së rezervuar duhet të jetë më e madhe se 100 metra nga vija kufizuese e qendrës së banuar. Po ky nen parashikon se Këshilli Bashkiak ka të drejtë të zvogëlojë gjerësinë e kësaj zone me vendim të motivuar, duke marrë paraprakisht mendimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.

Ndërkohë, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër, në Kreun VII "Varrezat", ka përcaktuar një brez sanitar prej 300 metrash për qendrën urbane të qytetit të Shkodrës, duke parashikuar njëkohësisht të drejtën e Këshillit Bashkiak për zvogëlimin e kësaj gjerësie.

Përvoja e zbatimit të PPV-së ka evidentuar se në territorin e Bashkisë Shkodër ndodhen varreza të krijuara prej shumë dekadash, të cilat sot janë të rrethuara nga zona të urbanizuara dhe të konsoliduara, siç janë "Varrezat e Rrmajit" dhe varreza të tjera. Zbatimi i brezit sanitar prej 300 metrash në këto raste kufizon në mënyrë të konsiderueshme zhvillimin e territorit përreth, duke penguar ndërhyrjet për rehabilitimin, rikonstruksionin, zgjerimin, rigjenerimin urban dhe konsolidimin e zonave ekzistuese, si dhe duke kufizuar realizimin e investimeve publike e private në përputhje me parashikimet e zhvillimit territorial.

Për sa më sipër, duke vlerësuar nevojën për të harmonizuar kërkesat e mbrojtjes sanitare me nevojat reale të zhvillimit urban, propozohet miratimi i gjerësisë së zonës së rezervuar për varrezat në 101 (njëqind e një) metra nga vija kufizuese e qendrës së banuar. Kjo gjerësi respekton standardin minimal të përcaktuar nga ligji dhe krijon kushte për një zhvillim më të balancuar dhe funksional të territorit.

Në zbatim të nenit 4 të Ligjit nr. 9220, datë 15.04.2004, i ndryshuar, është marrë mendimi pozitiv i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, me shkresën nr. 532/1 Prot., datë 01.07.2026, i cili mbështet propozimin për zvogëlimin e gjerësisë së zonës së rezervuar.

Për sa më sipër, propozohet miratimi nga Këshilli Bashkiak i projektvendimit "Për miratimin e gjerësisë së zonave të rezervuara për varrezat".

Duke ju falënderuar për shqyrtimin e këtij propozimi.

K R Y E T A R
BENET BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z / KRYETAR
ALBAN PREKA



*Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe
Kontrollit të Territorit*

Mikel KAPSAJ

*Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të
Territorit*

Dorina ISUFI

*Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të
Territorit*

Dionis DRAGANI

736



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 16688 Prot

Shkodër, më 19.6.2026

Lënda: Kërkesë për shprehje mendimi

INSPEKTORATIT SHTETËROR SHËNDETËSOR
Rruga Aleksandër Moisiu, Nr. 80, Tiranë

Në kuadër të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër janë evidentuar vështirësi në zbatimin e parashikimeve që lidhen me brezin sanitar të varrezave.

PPV-ja e Bashkisë Shkodër, në Kreun VII "Varrezat" aktualisht përcakton për brezat sanitar:

"Varrezat duhet te jene te izoluar nga zonat e banimit nëpërmjet zonës se rezervuar. Ndalohej te bëhen ndërtime te reja apo te zgjerohen ato ekzistuese brenda zonës se rezervuar. Ne qendrat e banuara në qytetin Shkodër, gjerësia e zonës se rezervuar është 300 m nga vija kufizuese e qendrës se banuar. Këshilli bashkiak ose komunal ka te drejte te zvogëlojë gjerësinë e zonës se rezervuar. Kjo behet vetëm me vendim të motivuar, duke marre mendimin e inspektoratit sanitar."

Ndërkohë, në territorin e Bashkisë Shkodër ndodhen varreza të krijuara prej kohësh brenda zonave tashmë të urbanizuara dhe të konsoliduara, si "Varrezat e Rrmajit", "Varrezat e Vjetra Myslymane" etj., ku zbatimi i brezit sanitar prej 300 m krijon kufizime të konsiderueshme në zhvillimin urban dhe në procesin e shqyrtimit të lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit.

Për këtë arsye, Bashkia Shkodër po përgatit dokumentacionin për reduktimin e kësaj distance në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9220/2004, duke parashikuar një brez sanitar prej 101m.

Për sa më sipër, në përputhje me Nenin 4 të Ligjit Nr.9220, datë 15.4.2004 "Për Administrimin e Shërbimit të Varrimit" i ndryshuar dhe Kreun VII "Varrezat" të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, kërkojmë mendimin dhe konfirmimin tuaj lidhur me këtë propozim, për aplikimin e një brezi sanitar prej 101m.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

KRYETAR

BENET BECI

ME VENDIM DELEGIMI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MIRËQËNIES SOCIALE
INSPEKTORATI SHTETËROR SHËNDETËSOR
DEGA RAJONALE SHKODËR

Nr 5324 Prot.

Shkodër, me 01.07. 2026

Lënda: Shprehje mendimi

Drejtuar: Bashkia Shkodër

Për dëjën: Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Tiranë

Në përgjigje të shkresës me Nr.16688 Prot.datë 19.06.2026 ,me objekt shprehje mendimi lidhur me propozimin për reduktimin e brezit sanitar të “Varrezave të Rrmajit” dhe “Varrezave të Vjetra Myslimane” ju bëjmë me dije se :

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Dega Rajonale Shkodër me Urdhër rr 27 dt 01.07.2026, rezultoi se gjatë verifikimit në terren është konstatuar se në afërsi të “Varrezave të Rrmajit” dhe varrezat e tjera të Bashkisë Shkodër, ndodhen objekte në një distancë më të vogël se 101 metra, ndërsa në “Varrezat e vjetra Myslimane” nuk ushtrohet më shërbim funeral. Zhvillimi urban ka krijuar një situatë të konsoliduar, ku ruajtja e brezit fillestar sanitar nuk korrespondon më me realitetin në terren. Për më tepër, për “Varrezat e Vjetra Myslimane” mungesa e aktivitetit funeral redukton ndjeshëm arsyet që justifikojnë ruajtjen e të njëjtit brez sanitar. Për sa kohë që ndryshimi i propozuar nuk çënon mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisit dhe interes publik, si dhe respektohen kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe merren të gjitha miratimet e nevojshme nga autoritetet kompetente, nuk evidentohet ndonjë pengesë juridike për vijimin e procedurës për reduktimin e brezit sanitar.

Për rrjedhojë, nga pikëpamja juridike vlerësohet se propozimi për reduktimin e brezit sanitar mund të mbështetet, duke vijuar procedurat sipas legjislacionit në fuqi dhe duke respektuar kushtet sanitare të përcaktuara nga organet kompetente.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

VENDIME, UDHEZIME, SHKRESA, KËRKESA
NR. 17408 DATE 21.07.2026
DREJTUAR NGA:
LËNDA

KRYEINSPEKTORI

Gjergj SOKOLI

OROSIA E TITULLARIT: